

Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës si dhe në mbështetje të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të konkursit në Sektorin Publik, NP "Termokos" SH. A,shpall:

K O N K U R S

PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Titulli i pozitës: **Kontrollor për verifikimin e lidhjeve të reja - një (1) vend pune**

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Bënë kontrollimin e të gjitha kyçjeve ekzistuese në teren;
- Verifikon kyçjet e reja,
- Përpilimin e procesverbalit të verifikimit në teren të kyçjeve të reja;
- Identifikon konsumatorët të cilët shfrytëzojnë energjinë ngrohëse në mënyrë të paautorizuar;
- Verifikon ndryshimet e llojit të destinacionit të sipërfaqes ngrohëse;
- Verifikon të dhënat personale të konsumatorëve.
- Përgatitë listën e përgjithshme të konsumatorëve të verifikuar;
- Bënë verifikimin e sipërfaqes ngrohëse te konsumatorët;
- Bënë përgatitjen e lëndëve për shërbimet në vijim për ekzekutim të lëndës;
- Mbi punën e kryer raporton në baza ditore dhe javore;

Kualifikimet dhe përgatitja profesionale

- Shkollim i mesëm ose i lartë.
- Tri (3) vite përvojë pune në fushën përkatëse.
- Njohja e mirë e punës me kompjuter (Microsoft Office).
- Të ketë aftësi komunikuese dhe të jetë në gjendje të punojë i pavarur dhe në ekupe, të jetë fleksibil në ndryshime dhe orar, si dhe ti përballojë punën nën presion.

Informatë për procedurën e konkurimit

Aplikantët e interesuar për këtë vend pune duhet të bashkangjesin këto dokumente:

- Aplikacionin e plotësuar.
- CV e aplikantit.
- Dëshminë e kualifikimit shkollor.
- Dëshminë mbi përvojën e punës nga Trusti pensional, referencat si dhe certifikata tjera profesionale.
- Certifikatën nga Gjykata që nuk jeni nën hetime (Valide dhe Origjinale).
- Dokumentin e identifikimit - letërnjoftimi i fotokopjuar.
- Letër Motivuese për pozitën të cilën aplikoni.

Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit në faqet zyrtare të NP "Termokos" Sh.A, si dhe në gazetatat ditore, duke filluar nga data 10.11.2021 deri me datë 24.11.2021 si datë e mbylljes së konkursit. Aplikantët e interesuar kërkesën për aplikim me dokumentacion të rregullt, apo përmes postës duhet ta paraqesin në arkivin e NP "Termokos" Sh.A., Rr. 28 Nëntori nr. 181, në Prishtinë, çdo ditë pune prej orës 8:30 – 15:30. Aplikacioni mund të shkarkohet nga webfaqja e "Termokos"-it www.termokos.org apo mund të merret në zyrat e ndërmarrjes. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen. Informatat shpesh mund të sigurohen përmes numrit të telefonit: 038/ 541-780.

Këtu mund të shkarkoni aplikacionin duke mbajtur shtypur tastin CTRL dhe duke klikuar Shkarko Aplikacionin me ngjyre të kaltër: [Shkarko Aplikacionin](#)